

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuave F. G., Z. G., A. J. dhe F. J., të gjithë nga Prizreni, për shkak të veprës penale në bashkë kryerje lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KP-së. sipas aktakuzës të Prokurorisë themelore në Prizren PP.nr.1262/2013 të datës 25.02.2014, pas mbajtjes së seancës kryesore publike në praninë e të akuzuarve F. G., Z. G. dhe A. J., dhe mbrojtësi të akuzuarit të tij avokat M. Ç., me datë 21.12.2015 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.F. G., nga i ati Z. e ëma M. e lindur Xh., i lindur me datë *data e lindjes...*, në Prizren, ku edhe jeton, rruga ..., ka të kryer shkollën fillore, vullkanizer, i martuar, baba i një fëmijut, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

2.Z. G., nga i ati N., dhe e ëma Sh. e lindur D., i lindur më *data e lindjes...* në fshatin B., Komuna e Dragashit, tani jeton në Prizren, rruga ..., nr..., ka të kryer shkollën e mesme, pensionist, i martuar, baba i tre fëmijëve, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës.

3.A. J., nga i ati M. dhe e ëma Xh., të vajzërisë F., i lindur me *data e lindjes...*, në Prizren, ku edhe tani jeton në rrugën ..., nr..., ka të kryer shkollën e mesme, berber, i shkurorizuar, baba i një fëmijut, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

4. F. J., nga i ati M. dhe e ëma Xh., të vajzërisë F., i lindur me *data e lindjes...*, në Prizren, ku edhe tani jeton në rrugën ..., nr..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë F A J T O R

Të akuzuarit F. G. dhe Z. G.:

I.Se me datën 31.03.2013 rreth orës 17,45 minuta, në Prizren, në rrugën ..., pikërisht në oborrin e shtëpisë së të pandehurve, i shkaktojnë lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit A. J., që rezultojn me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, në atë mënyrë në momentin që i dëmtuari së bashku me djalin e vëlaut të tij B. J., e dërgon fëmijun e tij 2 vjeçar në shtëpinë e të pandehurve, meqenëse me vendim të gjykatës i dëmtuari ditën kritike ka pasur të drejtë ta merre nga bashkëshortja e tij, në kujdes fëmijun e tij, djalin të pandehurit dhe pas një fjalosje, e godasin me

grushta në pjesën të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje e indeve të buta të kokës, dhe plagë shquese në buzën e sipërme,

Me këto veprime në bashkë kryerje kryejnë veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KP-ës.

II.me datë, kohë dhe vend dhe mënyrë të njëjtë të përshkruar si në dispozitivin e I. i shkaktojnë lëndime të lehtë trupor të dëmtuarit B. J., që rezulton me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit, e godasin me grushta në kokë duke shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje të indeve të buta në kokë dhe nën syrin e djathë.

Me këto veprime në bashkë kryerje kryejnë veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KP-ës.

I pandehuri F. G.

III.Me datën 02.04.2013 në Prizren, përballë restorantit “M.”, i shkaktojnë lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit F. G., që rezulton me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit, në atë mënyrë, që pas mbajtjes së seancës për shkurorëzimin e motrës së tij – F. me të pandehurin A., fillojnë të fjalosen, e më pas e godet me grushta në pjesën të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje të indeve të buta me gërvishtje në mollëzën e majtë të fytyrës.

Me këto veprime në bashkë kryerje kryejnë veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KP-ës.

Të pandehurit A. J. dhe F. J.,

IV.Me datën 02.04.2013, në Prizren, përballë restorantit “M.”, i shkaktojnë lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit F. G., që rezulton me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit, në atë mënyrë, që pas mbajtjes së seancës për shkurorëzim e motrës së tij F. me të pandehurin A., fillojnë të fjalosen, e më pas e godet me grushta në pjesë të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje të indeve të buta me gërvishtje në mollëzën e majtë të fytyrës,

Me këto veprime në bashkë kryerje kryejnë veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KP-ës.

I pandehuri A. J.,

V.Me datën 02.04.2013, në Prizren, përballë restorantit “M.”, i shkakton lëndim të lehtë trupor të dëmtuarës – bashkëshortes së tij F. J., në atë mënyrë që i revoltuar pas mbajtjes së

seancës gjyqësore për shkurorëzim fillon të fjaloset, e më pas e kap për flokë, si pasojë e së cilës e dëmtuara rrëzohet, duke pësuar lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje e indeve të buta me gërvishtje në gjunjë dhe kërcinjë,

Me këto veprime kryen veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KP-ës.

I pandehuri F. G. dhe Z. G..

VI. Me datën 02.04.2013, në Prizren, p0ërballë restorantit “M.”, i shkaktojnë lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit F. J., në atë mënyrë që të revoltuar pas mbajtjes së seancës gjyqësore për shkurorëzim, fillon të fjaloset, e më pas e godasin me grushta në pjesë të ndryshme të trupit duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje e indeve të buta me gërvishtje në kokë, qafë dhe në të dy duart.

Me këto veprime kryen veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KP-ës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76, 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31, 188 par.1 nën par.1.4 dhe nenit 188 par.3 lidhur me par.1.4 të KP-së, të akuzuarve ju shqipton:

1. Të akuzuarit të parë F. G.:

Për veprën penale nën I të dispozitivit

Dënimi me burgim prej 3 (tre) muajve,

Për veprën penale nën II të dispozitivit.

Dënimi me burgim prej 3 (tre) muajve.

Për veprën penale nën III të dispozitivit

Dënimi me burgim prej 3 (tre) muajve.

Për veprën penale nën VI të dispozitivit

Dënimi me burgim prej 3 (tre) muajve.

Komform nenit 80 par.1 dhe 2 pika 2.2 të KP-ës, gjykata i shqipton dënimin unik dhe atë:

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat të verifikimit prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen ndonjë veprë të re penale

2. Të akuzuarit Z. G.:

Për veprën penale nën I të dispozitivit

Dënimi me burgim prej 3 (tre) muajve,

Për veprën penale nën II të dispozitivit.

Dënimi me burgim prej 3 (tre) muajve.

Për veprën penale nën VI të dispozitivit

Dënimi me burgim prej 3 (tre) muajve.

Komform nenit 80 par.1 dhe 2 pika 2.2 të KP-ës, gjykata i shqipton dënimin unik dhe ate:

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat të verifikimit prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen ndonjë vepër të re penale

3. Të akuzuarit A. J.:

Për veprën penale nën IV të dispozitivit

Dënimi me burgim prej 3 (tre) muajve,

Për veprën penale nën V të dispozitivit

Dënimi me burgim prej 6 (gjashtë) muajve.

Komform nenit 80 par.1 dhe 2 pika 2.2 të KP-ës, gjykata i shqipton dënimin unik dhe ate:

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat të verifikimit prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen ndonjë vepër të re penale

4. Të akuzuarit F. J.:

Për veprën penale nën IV të dispozitivit

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen ndonjë vepër të re penale

Të akuzuarit obligohen që të paguajnë në mënyrë solidare shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe ate në emër të ekspertizës mjeko ligjore, shumën prej 40,88 euro, si dhe në emër të

paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumen prej 20,00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate, i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1262/2013 të datës 19.06.2015 kundër të akuzuarve F. G., Z. G., A. J. dhe F. J., të gjithë nga Prizreni, për shkak të veprës penale në bashkë kryerje lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KP-së

Prokurori i shtetit Zejnulla Gashi në fjalën e tij përfundimtare deklaron: mbetem në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.1262/2013 të datës 19.06.2015, të parashtruar ndaj të akuzuarve F. G., nga Prizreni, për shkak të veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KP-ës, dhe veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KP-ës, Z. G., nga Prizreni, për shkak të veprave penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.1 e lidhur me nenin 31 të KP-ës, A. J., për shkak të veprave penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KP-ës dhe veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KP-ës dhe F. J., nga Prizreni, për shkak të veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KP-ës, pasi që pranimi i fajësisë është bërë konform nenit 248 të KPP-ës, ngase të akuzuarit kanë pranuar fajësinë në të gjitha pikat të aktakuzës, andaj propozoj gjykatës që nga të cekurat si dhe në bazë të provave tjera dhe shkresave që janë pjesë përbërëse të kësaj lënde në këtë çështje penale, pa mëdyshje vërtetohet që në veprimet e këtu të akuzuarve janë plotësuar të gjitha elementet e veprave penale që ju vihen në barë, andaj propozoj që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit, paraprakisht duke i marr për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

I akuzuari i parë F. G., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoj fajësinë për të gjitha veprat penale e cilat më vihen në barë, por i propozoj gjykatës që të gjitha shkaqet dhe arsyet që kanë shkaktuar deri te vepra penale tani i takojnë të kaluarës, ngase që nga ajo kohë e deri më tani më nuk kemi pasur asnjëherë problem me palën tjetër, këtu të akuzuarit tjerë. pendohem thellë për veprat e shkaktuara, i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, jam person familjar, baba i një fëmijë, dhe me punën time të vulkanizerit, kujdesem për ekzistencën e familjes.

I akuzuari i dytë Z. G., në fjalën e tij përfundimtare deklaron. e pranoj fajësinë për veprat penale që më vihen në barë, ne kemi qenë me të akuzuarin A. J. dhe familjen J. në miqësi gjashtë vjeçare, pasi që bija ime F. G. ka qenë e reja e familjes J., konkretisht bashkëshorti e të akuzuarit A. J.. më vije keq për tërë që ka ndodhur, unë jam person familjar, dhe me punën time të kohë pas kohshme jam munduar të siguroj ekzistencën e familjes sime. tani jam pensionist, dhe baba i tre fëmijëve, për të cilët kujdesem brenda mundësive të mija që të njëjtit të kenë një të ardhme sa më të mirë. si vullnet dhe dëshirë që kjo çështje penale të përfundoj, theksoj edhe faktin që biri i vajzës sime e cila ka qenë e re në familjen J. është duke u rritur dhe edukuar në familjen time pas shkurorëzimit të bijës sime me ish bashkëshortin e tij A. J., andaj edhe kjo rrethanë ndikon që të pranojë fajësinë si dhe ti premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë

veprat të tilla apo të ngjashme, dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla. konsideroj dhe i propozoj gjykatës që të gjitha të cekura më lart gjykata ti ketë parasysh si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin.

Mbrojtësi i të akuzuarit të tretë A. J., avokat M. Ç., në fjalën e saj përfundimtare deklaron: me vetë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, unë si mbrojtëse nuk kam çka të lëshohem lidhur me gjendjen faktike, por i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim ta merr si rrethanë lehtësuese, dhe se i mbrojturi im me rastin e kryerjes së veprës penale e cila i vihet në barë ka qenë i provokuar nga ana e palës së kundërt, duke pasur parasysh faktin që i njejtë është edhe baba i fëmijut të lindur nga ish martesë me vajzën e të akuzuarit Z. G. gjegjësisht motrën e të akuzuarit F. G., e i cili fëmijë tani është duke u rritur dhe edukuar tek nëna e tij, gjegjësisht tek gjyshi dhe dajët, pasi që i mbrojturi im është shkukurorëzuar. po ashtu kontaktet në mes të mbrojturit tim dhe fëmijës të tij i cili gjendet në rritje dhe edukim tek familja G. janë të rregullta çdo të diele, dhe konsideroj dhe i propozoj gjykatës që këtu raportet të tanishme mes palëve mund të ndryshojnë me shqiptimin e ndonjë mase sanksionuse më të ashpër se sa një vërejtje gjyqësore ndaj të mbrojturit tim. konsideroj që të gjitha këto rrethana të cekura më lart gjykata ti merr parasysh si rrethana lehtësuese.

I akuzuari A. J., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoj dhe e përkrahi në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtëses time dhe nuk kam tjetër çka të shtoj.

I akuzuari i katërt F. J., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoj veprat penale për të gjitha pikat që më vihen në barë sipas aktakuzës, e tëra që ka ndodhur në mes nesh, i takon të kaluarës, që nga momenti i shkaktimit të kësaj vepre e deri më sot më nuk kemi pasur kurrfarë mosmarrëveshje me palën e kundërt, andaj i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë, që jam person familjar, baba i dy fëmijëve, si dhe fakti që pendohej thellë për veprën penale të shkaktuar si dhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe i premtoj gjykatës që do të përmbahem nga veprimet të tilla apo të ngjashme, të gjitha këto gjykata ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrës vendimit mbi dënimin.

E dëmtuara F. G. – J. deklaron që si palë e dëmtuar nuk parashtron kërkesë pronësoro juridike,

I dëmtuari B. J. deklaron që si palë e dëmtuar nuk parashtron kërkesë pronësoro juridike.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Të akuzuarit F. G. dhe Z. G.:

Se me datën 31.03.2013 rreth orës 17,45 minuta, në Prizren, në rrugën ..., pikërisht në oborrin e shtëpisë së të pandehurve, i shkaktojnë lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit A. J., që rezulton me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, në atë mënyrë në momentin që i dëmtuari së bashku me djalin e vëlaut të tij B. J., e dërgon fëmijun e tij 2 vjeçar në shtëpinë e të pandehurve, meqenëse me vendim të gjykatës i dëmtuari ditën kritike ka pasur të drejtë ta merre nga bashkëshortja e tij, në kujdes fëmijun e tij, djalin të pandehurit dhe pas një fjalosje, e godasin me

grushta në pjesën të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje e indeve të buta të kokës, dhe plagë shquese në buzën e sipërme,

II. me datë, kohë dhe vend dhe mënyrë të njëjtë të përshkruar si në dispozitivin e I. i shkaktajnë lëndime të lehtë trupor të dëmtuarit B. J., që rezulton me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit, e godasin me grushta në kokë duke shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje të indeve të buta në kokë dhe nën syrin e djathë.

I pandehuri F. G..

Me datën 02.04.2013 në Prizren, përballë restorantit “M.”, i shkaktajnë lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit F. G., që rezulton me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit, në atë mënyrë, që pas mbajtjes së seancës për shkurorëzimin e motrës së tij – F. me të pandehurin A., fillojnë të fjalosen, e më pas e godet me grushta në pjesën të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje të indeve të buta me gërvishtje në mollëzën e majtë të fytyrës.

Të pandehurit A. J. dhe F. J.,

Me datën 02.04.2013, në Prizren, përballë restorantit “M.”, i shkaktajnë lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit F. G., që rezulton me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit, në atë mënyrë, që pas mbajtjes së seancës për shkurorëzim e motrës së tij F. me të pandehurin A., fillojnë të fjalosen, e më pas e godet me grushta në pjesë të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje të indeve të buta me gërvishtje në mollëzën e majtë të fytyrës,

I pandehuri A. J.,

Me datën 02.04.2013, në Prizren, përballë restorantit “M.”, i shkaktajnë lëndim të lehtë trupor të dëmtuarës – bashkëshortes së tij F. J., në atë mënyrë që i revoltuar pas mbajtjes së seancës gjyqësore për shkurorëzim fillon të fjaloset, e më pas e kap për flokë, si pasojë e së cilës e dëmtuara rrëzohet, duke pësuar lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje e indeve të buta me gërvishtje në gjunjë dhe kërcinjë,

I pandehuri F. G. dhe Z. G..

Me datën 02.04.2013, në Prizren, përballë restorantit “M.”, i shkaktajnë lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit F. J., në atë mënyrë që të revoltuar pas mbajtjes së seancës gjyqësore për shkurorëzim, fillon të fjaloset, e më pas e godasin me grushta në pjesë të ndryshme të trupit duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje e indeve të buta me gërvishtje në kokë, qafë dhe në të dy duart.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe atë të katër të akuzuarit në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat e propozuara. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprat penale të cilat ju vihen në barrë dhe që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të

akuzuarit kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprave penale dhe ate për të akuzuarin e pare F. G., për shkak të veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KP-ës dhe veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KP-ës, për të akuzuarin e dytë Z. G., për shkak të veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KP-ës, për të akuzuarin e tretë A. J., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KP-ës dhe veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nën par.1.4 të KP-ës, dhe të akuzuarit të katërt F. J., për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KP-ës, paraprakisht duke vërtetuar përgjegjësin e tyre penalo juridike për veprat penale që ju vihen në barë.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese si rrethana lehtësuese janë marrë faktet se të akuzuarit kanë bashkëpunuar me organet gjyqësore që nga faza fillestare, të njëjtit kanë pranuar fajësinë për të gjitha veprat penale, pendimet e tyre për veprat penale që i kanë kryer, konform nenit 74 gjykata ka marr parasysh rrethanat personale dhe karakterin e personave të dënuar, janë persona familjar, i akuzuari i pare F. G. është baba i një fëmiju, i akuzuari i dytë Z. G. është baba i tre fëmijëve, i akuzuari i tretë A. J. është baba e një fëmijut dhe i akuzuari i katërt F. J. është baba i dy fëmijëve, kjo është hera e pare që kanë ranë në konflikt me ligjin, deri më tani nuk kanë qenë të gjykuar, çka do të thotë që nuk kanë ra ndesh me rregullat positive dhe i kanë respektuar të njejtat, bashkëpunimin e përgjithshëm të personave të dënuar me gjykatën, bashkëpunimi i personave të dënuar në hetimin në ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga personat e dënuar, sjelljen e personave të dënuar pas kryerjes së veprës penale, andaj gjykata të akuzuarit i shpalli fajtor dhe ju shqiptoj dënimet dhe ate të akuzuarit të parë F. G. për katër veprat penale i shqipton dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat të verifikimit prej 2 (dy) viteve nga dita e plotëfuqëshmërisë të këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, paraprakisht duke i shqiptuar dënimin për secilën vepër penale veç e veç, të akuzuarit të dytë Z. G. për tre veprat penale i shqipton dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat të verifikimit prej 2 (dy) viteve nga dita e plotëfuqëshmërisë të këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, paraprakisht duke i shqiptuar dënimin për secilën vepër penale veç e veç, të akuzuarit të tretë A. J. për dy veprat penale i shqipton dënimin unik me burgim në zgjatje prej 8 (tetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat të verifikimit prej 2 (dy) viteve nga dita e plotëfuqëshmërisë të këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, paraprakisht duke i shqiptuar dënimin për secilën vepër penale veç e veç, dhe të akuzuarit të katërt F. J. i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat të verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqëshmërisë të këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, duke vërtetuar përgjegjësin e tyre penalo juridike, si dhe duke menduar se dënimi i shqiptuar ju përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tyre, peshës dhe pasojave të veprave penale të shkaktuara, duke menduar se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen do të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.309/2014 me datë 21.12.2015

Procesmbjatesja
Naxhis Sharani,

Gjyqtari,
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.